



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETARI

Nr. 411 Prot

Shkodër, më 11.01.2019

V E N D I M

Nr. 09 Date 11.01.2019

“Për delegimin e kompetencave”

Në mbështetje të nenit 8.9 të ligjit nr 139/2015 " Për vetqeverisjen vendore", në nenet 28, 29 të ligjit nr. 44. datë 30.4.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, të ligjit nr.10296 datë 8. 7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, udhëzimit nr.2 datë 6.2.2012 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar,

V E N D O S A:

- I. Delegimin e kompetencës së titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkoder, zv/kryetarit, zj.Emilja Koliqi, për nënshkrimin e akteve të proçedurave të prokurimit, vlera e të cilave, brenda një viti kalendarik është më e vogël se 800.000 (tetëqind mijë) lekë.
- II. Delegimin e kompetencës si nëpunës i autorizuar, Bashkia Shkoder, zv/kryetarit, zj.Emilja Koliqi, për kryerjen e pagesave për zërat e shpenzimeve: paga, sigurime shoqërore e shëndetësorë, TAP, transferta, shpenzime për energji elektrike, ujë dhe postë.
- III. Kompetencat e deleguara, do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri deri në datën 31.12.2019.
- IV. Raportimi të kryhet tek nëpunësi Autorizues, me shkrim çdo muaj pasardhës, për realizimin e detyrave të ngarkuara.

V. Zv/kryetari, nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen web të Bashkisë Shkoder.

KRYETAR  
Violetana ADEMI

